



**Kuvendi i Komunës Klinë**

Nr prot. 06-32258 /2024

Datë: 29.09 /2024

*Duke u mbështetur në Nenin 12 paragrafi 12.2 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës. Nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-048, Nenin 2, 3 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049. Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024. Me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim si dhe me rekomandimin e KPF-së datës: 06.09.2024, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII-të të rregullt për vitin 2024, të mbajtur me datën: 20.09.2024 mori këtë:*

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për rialokim të mjeteve buxhetore në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale, fondi burimor 10, 21 dhe 22.
2. Rialokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale, burimi i financimit (10) në kuadër të programit **Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660)**, nen-programi **Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395)**, kodi funksional (0620), nga projektet:
  - “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Siqevë – Ujmirë – Shtaricë”, kodi (54294), shuma **5,996.00 €**;
  - “Ndërtimi i shtratit te lumit Drini i Bardhe ne Klinë, Volljak”, kodi (54334), shuma **32,795.47 €**.
  - “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Videje – Polce – Paskalicë - Jagode-Krushev e Madhe”, kodi (54285), shuma **1,000.00 €**.
    - **Rialokohen në projektet:**
    - “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Krushevë e Vogël (trotuari Kline-Zllakuqan), kodi (54341), shuma **9,763.00 €**.
    - “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore ne Gremnik”, kodi (54292), shuma **24,000.00 €**
    - “Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore ne Kline-Dersnik-Dollc”, (kodi 54280), shuma **6,028.47 €**

3. Rialokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale, burimi i financimit (21) **Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), nga projektet:**

- “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Lagjen Arberia, Tigvesh, të Sheshit Nena Tereze, Dollc-Dresnik, Grabanicë, Gremnik, Drenoc”, kodi (54332), shuma **4,497.00 €**

**Rialokohen në projektet:**

- “Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradović, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore në Kline-Dersnik-Dollc”, kodi (54280), shuma **4,497.00 €**

4. Rialokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale, burimi i financimit (22) **Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), nga projektet:**

- “Asfaltimi i rrugës Afrim Haliti në Jashanicë”, kodi (52442), shuma **2,849.51 €**
- “Ndërtimi i parkut industrial për Klinë”, kodi (52447), shuma **9,000.00 €**

**Rialokohen në projektet:**

- Në projektin “Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradović, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore në Kline-Dersnik-Dollc” (kodi 54280), shuma **11,849.51 €**.

**ARSYETIM: Rialokimi i mjeteve brenda programit bëhet për harmonizimin e mjeteve për përfundimin e punëve sipas kontratave.**

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
6. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullore (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullore (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Me këtë vendim njoftohen:**

- **MAPL;**
- **Kryetari i Komunes;**
- **Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim;**
- **Zyra për Informim;**
- **Arkivi;**



**Kryesues i Kuvendit  
Fadil Gashi**